



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Komiteti për Komunitete

Data: 21.07.2026

Për: Anëtarët e Komitetit për Komunitete – KpK

FTESË

Të nderuar anëtar/e,

Ju ftojme që të merrni pjesë në mbledhjen e V- të Komitetit për Komunitete për vitin 2026. Mbledhja do të mbahet me dt. 21.07.2026 (e martë), ora: 10:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Vërejtje: Komiteti për Komunitete mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Komitetit për Komunitete dt. 19.06.2026.
3. Raporti i Zyrës për Kthim dhe Komunitete.
4. Raporti i Nënkrëtarit të Komunës për Komunitete.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete
Muamel Dupljak



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA**



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KOMITETI PËR KOMUNITETE

PROCESVERBAL

Mbledhja e III -te e Komitetit për Komunitete u mbajt më 19.06.2026, në ora 10:00, në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Të pranishëm:

1. Dafina Draga (LDK) – Anëtare e Kuvendit
2. Vjendita Kelmendi-Gërkoci (AAK) – Anëtare e Kuvendit
3. Mubera Belegu (LVV) – Anëtar i Kuvendit
4. Muamel Dubljak (BSK) – Anëtar i Kuvendit
5. Mirsad Berisha (PLE) – Anëtar i Kuvendit
6. Miloš Dimitrijević (SERB) – Përfaqësues i komunitetit Serb **(Mungoi pa arsyetim)**
7. Omer Dacić – Përfaqësues i komunitetit Boshnjak
8. Edmir Delija – Përfaqësues i komunitetit Egjiptian
9. Sofije Toska – Përfaqësuese e komunitetit Rom

Të pranishme ishin edhe znj. Valbone Belegu Osce dhe znj. Ajshe Qela UNMIK, të cilat i falënderojmë për pjesëmarrjen.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Komitetit z.Muamel Dubljak i cili përshëndeti të pranishmit dhe vazhdoi me rendin e ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.05.2026;
3. Raporti i Zyrës për Komunitete;
4. Raporti i Drejtorisë për Financa lidhur me përgatitjen e buxhetit për komunitete dhe buxhetin komunal për vitin 2027.

Procesverbalin e kësaj mbledhjeje do ta mbajë znj. **Vjendita Kelmendi Gergoci**.

Kryesuesi:

Pyeti nëse ka propozime apo ndryshime për procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Z. Sabahudin:

Kërkoi të korrigohej procesverbali, duke cekur se janë kryer 5 raste dhe jo 15 raste. Mund të jetë gabim teknik. Janë shqyrtuar 15 raste dhe 5 janë aprovuar.

Pas këtij korrigjimi, procesverbali u miratua.

Raporti i Zyrës për Komunitete

Shefi i Zyrës për Komunitete paraqiti raportin, duke njoftuar se, sa i përket punës sonë, nuk kemi pasur vëllim të madh, përveç punëve të zakonshme.

Janë realizuar vizita në familje për analizimin e gjendjes së tyre.

Kemi edhe dy raste që kanë ardhur për t'u informuar lidhur me procedurat. Familjeve u janë shpërndarë formularët për aplikim, ndërsa rastet do të shqyrtohen pas pranimi të aplikimeve.

Nuk ka raste të reja të riatdhesimit. Por dy familje që kanë aplikuar më herët kanë marrë vendimet për strehim. Tani ka mbetur nga ministria që t'i zbatojë këto vendime. Kanë përfituar të drejtën për strehim 12 muaj dhe pritet aprovimi përfundimtar nga ministria.

Kryesuesi e falënderoi shefin e Zyrës për Komunitete për raportin dhe hapi diskutimin. Meqenëse nuk pati pyetje apo komente, u kalua në pikën e radhës.

Kryesuesi ia kaloi fjalën **z. Gazmend Turku**.

Raporti i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Z. Gazmend Turku:

Përshëndeti të pranishmit dhe paraqiti informatën lidhur me përgatitjen e buxhetit për komunitetet jo shumicë për vitin 2027.

Ai bëri të ditur se:

Si çdo herë, edhe këtë vit tashmë keni njohuri që qarkorja buxhetore vjen në pjesën e dytë të muajit maj.

Ka ardhur qarkorja buxhetore e parë prej Ministrisë së Financave, është e vitit 2027/01.

Jemi duke e përgatitur KAB-in, pra Kornizën Afatmesme Buxhetore, për periudhën 2027/2029. Buxheti i vitit 2027 është planifikuar në shumën 44,119,678 euro, krahasuar me vitin 2026, i cili ishte 41,953,838 euro, duke shënuar një rritje prej rreth 2.2 milionë euro.

Unë po i përmendi 3 vlerat që janë të ndara në grandin e përgjithshëm, grandin e arsimit dhe shëndetësisë, mirëpo kompleti i buxhetit për vitin 2027 është 44,119,678 €.

Komuna e Pejës ka përfshirë nevojat e komuniteteve në planifikimin buxhetor.

Investimet në infrastrukturë synojnë trajtim të barabartë të të gjitha komuniteteve, përmes projekteve të ndriçimit publik dhe asfaltimit të rrugëve, pa dallim të nacionaliteteve.

Ndër projektet e planifikuara u përmendën, pa përmendur shumat:

Ndërtimi dhe ndriçimi i rrugëve në Zlopek, Gorozhdec, Brestovik dhe Vitomiricë.

Ndërtimi i rrugës në fshatin Levozhë.

Këto janë të përfshira në planifikimin e buxhetit 2027/2029, pra për 3 vitet e ardhshme.

Ne jemi në pritje të kërkesave tuaja që ju i adresoni në adresën e Komunës, Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, që të kemi një planifikim sa më të mirë dhe me i identifikuar nevojat e qytetarëve.

Ju falënderoj për dëgjimin dhe ftesën. Jam i hapur për pyetje, nëse keni.

Z. Muamel:

E mori fjalën dhe i pyeti të pranishmit nëse kanë pyetje.

Z. Prof. Omer Dacic:

Në fshatin tonë shtyllat elektrike janë të vjetra dhe paraqesin rrezik për jetë, ndërsa gypat e ujës-jellësit janë shumë të vjetër dhe përmbajnë asbest, gjë që paraqet rrezik për shëndetin.

Gjithashtu, shtypja e ujit është e ulët dhe shpesh nuk kemi as ujë.

Çështja tjetër që deshta me cek është që rrugët në Vitomiricë janë shumë të ngushta. Rrugët janë të asfaltuara, por janë me gjerësi 3 metra dhe, për një kohë të shkurtër, kemi pasur 3-4 incidente që gati kanë ndodhur.

Gjithashtu kemi një numër të madh kërkesash nga bujqërit. Ata punojnë shumë, por nuk i kanë kushtet themelore për të punuar. Nuk kanë makineri, mekanizma dhe sera, pra që janë të nevojshme për punën e tyre.

Kërkoj që të rritet shuma e buxhetit për bujqësi.

Ju falënderoj shumë.

Kryesuesi:

E falënderoi profesorin Dacic dhe pyeti nëse ka pyetje të tjera.

Znj. Sofije Toska:

Përshëndetje, jam Sofije Toska nga komuniteti rom.

Deshta me ju pyet një pyetje.

A jeni të informuar për këtë rast? Unë kam pasur ankesa para një jave nga banorët. Në rrugën "Shaban Polluzha", te SHFMU "Xhemajl Kada", në anën e majtë, rruga është e ngushtë dhe e dëmtuar. Është premtuar që do të rregullohet. Nuk ka mundësi të kalojnë dy vetura. Kockat janë në të dy anët, por akoma nuk është rregulluar. Nuk është rrugë e gjatë, por ka nevojë të rregullohet.

Z. Gazmend Turku:

Është në planifikim edhe ndriçimi dhe asfaltimi i rrugëve 2027/2029.

Sa i përket zgjerimit të rrugëve, paraqitet problem sepse janë prona private të njerëzve. Për zgjerim të rrugës duhet të bëhet shpronësimi i tyre dhe kostoja është e lartë, sa që e pengon projektin për asfaltim dhe ndriçim.

Kërkesat nga Komiteti i paraqisni në Komunë, në Zyrën numër pesë. Është më e lehtë për neve kur marrim kërkesa. Edhe kërkesat e sotme patjetër që do t'i përcjell te drejtori dhe kolegët.

Valbona Belegu (OSBE):

A keni planifikuar dëgjime buxhetore në pjesët ku janë të banuara komunitetet?

Z. Gazmend Turku:

Sot fillojmë me dëgjime buxhetore.

Përmes e-mailit mund të bëjnë pyetje apo kërkesa.

Gjatë periudhës korrik-gusht do të jenë 10-11 dëgjime buxhetore nëpër pjesë të qytetit dhe zona rurale, duke i takuar banorët, me i informu dhe, në të njëjtën kohë, me marrë edhe pyetjet e kërkesat prej tyre, në mënyrë që ne me planifiku buxhetin.

Në të njëjtën kohë e kemi bërë edhe informimin në ueb-faqe që, përmes e-mailit, mund të bëjnë pyetje apo kërkesa, që mos keni nevojë të vini me i dorëzu në sportel.

Z. Muamel Dupljak:

Ju ftoj të gjithëve që të merrni pjesë në dëgjimin buxhetor sot në orën 12:00.

A keni ndonjë pyetje tjetër?

Po e përmbylлим këtë pikë të rendit të ditës dhe vazhdojmë me pjesën **Të ndryshme**.

A keni diçka të shtoni?

Deshta t'ju njoftoj që, sa i përket vizitave në terren, do ta vizitojmë fshatin Brestovik, takim kokë më kokë.

Znj. Valbona:

Kam disa formularë që do t'ua shpërndaja anëtarëve të komunitetit.

OSBE do të angazhojë një avokat që do të merret me çështjet e pazgjidhura me dokumente dhe qasje në shërbime publike. Nëse e dini dikë që ka nevojë, njoftojeni.

Janë në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.

Solla edhe të gjeturat nga trajnimet me OSBE. Është edhe Komiteti për Komunitete i Pejës.

Z. Muamel:

Nëse nuk keni pyetje, e mbyllëm takimin e sotëm

Procesmbajtëse

Vjendita Kelmendi Gergoci



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ**



SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ

Komitet za Zajednice

Datum: 21.07.2026

Za: Članove Komiteta za Zajednice- KZ

POZIV

Poštovani članovi/članice,
pozivamo vas da učestvujete na V sednici Komiteta za Zajednice za 2026. Godinu, koja će biti održana 21.07.2026 (u utorak) u 10:00 časova u Sali Komiteta za Politiku i Finansije.

Napomena: Komitet za Zajednice zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda.
2. Usvajanje zapisnika.
3. Izveštaj kancelarije za povratak i zajednice.
4. Izveštaj zamjenika predsjednika Opštine za zajednice.
5. Razno.

Prdesedavajući Komiteta za Zajednice
Muamel Dupljak